



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 05/L-072

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR HUA
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE
BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR
PROJEKTIN E REHABILITIMIT TË RRUGËS HEKURUDHORE 10**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR HUA
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE
BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR
PROJEKTIN E REHABILITIMIT TË RRUGËS HEKURUDHORE 10**

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të ratifikojë marrëveshjen për hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e rehabilitimit të rrugës hekurudhore 10.

Neni 2
Ratifikimi i Marrëveshjes

Ratifikohet Marrëveshja për hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e rehabilitimit të rrugës hekurudhore 10, e lidhur më 04 shtator 2015, në Londër.

Neni 3
Dokumentet e bashkëngjitura

1. Në Shtojcën nr. 1 të këtij ligji është e bashkëngjitur Marrëveshja për hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe zhvillim për projektin e rehabilitimit të rrugës hekurudhore 10.

2. Në Shtojcën nr. 2 të këtij ligji është e bashkëngjitur Termet dhe Kushtet Standarde të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, të datës 1 dhjetor 2012.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L-072
24 shkurt 2016

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kadri VESELI